



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.29/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Skender Çoçaj - kryesues, Arsim Hamzaj dhe Kymete Kicaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), me seli në Pejë, të paraqitur kundër subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Gjakovë, për shkak të shkeljes së dispozitave të Kodit të Sjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët, në zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të cilat do të mbahen me datë 28 dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 22.12.2025, merr këtë:

V E N D I M

I.PRANOHET E BAZUAR ankesa ZP.Anr.29/2025 e parashtruar nga Subjekti Politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), me seli në Pejë, të paraqitur kundër subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Gjakovë, për shkak të shkeljes së dispozitave të Kodit të Sjelljes për subjektet politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, në zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të cilat do të mbahen me datë 28 dhjetor 2025.

II. Subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej **2,000.00Euro (dymijë) Euro**.

III. Detyrohet Subjekti politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 20.12.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesën e parashtruar nga subjekti politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK) në të cilën pretendojnë se më datë 18.12.2026, rreth orës 18:30, Bekim Tallamashi, mbështetës dhe anëtar i PLE, ka publikuar në profilin e tij në rrjetin social në Facebook një video, të cilën pas pak kohë e ka fshirë, ku shihet duke plotësuar fletëvotime për persona të tjerë nga diaspora, të cilët i quan “klientë”, si dhe duke bërë thirrje publike për paraqitjen e “klientëve të tjerë” për të njëjtin qëllim, duke thirrur të votohet Partia Liberale Egjiptiane. Tutje, parashtruesi i ankesës thekson se në video shfaqen fletëvotime të pa-plotësuara për të cilat Bekim Tallamashi, mbështetës dhe anëtar i PLE, deklaroi se i ka pranuar për plotësim, si dhe konfirmon se ndodhet në një ambient me shumë persona të tjerë, sipas tij “duke i rregullu letrat dhe duke ndihmu”, e cila sipas ankuesit,

dëshmon qartazi manipulimin e organizuar si dhe fabrikimin e votës me postë të mërgtës nga Bekim Tallamashi dhe PLE. Ankuesi thekson se këto veprime përbejnë shkelje të rendë të LZP-së, duke cenuar parimin e votës së lirë, personale dhe sekrete, si dhe integritetin e procesit zgjedhor dhe poashtu bien ndesh me Rregullën Zgjedhore nr.11/2023 Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, konkretisht nenin 4, paragrafi 4.1.

Parashtruesi i ankesës pretendon se raporti zyrtar si anëtar dhe raporti i afërt si mbështetës i Bekim Tallamishit me PLE vërtetohet përmes fotove të bashkangjitura si provë në këtë ankesë dhe të cilat janë publike në profilin e tij në Facebook. Prandaj, kërkojnë nga PZAP-i që të vendos për pranimin e kësaj ankesë si të bazuar, ashtu që Bekimin Tallamishin dhe PLE ti dënoj sipas përcaktimeve përkatëse ligjore dhe nënligjore si dhe të njoftojë autoritetet kompetente për ndjekjen e kryerësve të veprave penale sipas nenit 9, par.9.2., të Rregullës Zgjedhore nr.11/2023 Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët: Shkeljet e Kodit të Mirësjelljes së përcaktuar nga PZAP-i, të cilat kanë tentuar të ndikojnë në rezultat të zgjedhjeve paraqesin vepër penale sipas Kodit Penal të Kosovës.

Si provë, parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur në ankesë video në CD me pamje dhe audio si dhe fotot të cilat sipas ankuesit dëshmojnë raportin zyrtar si anëtar dhe mbështetës të Bekim Tallamishit me Partinë Liberale Egjiptiane.

Në përgjigjen në ankesë të subjektit politik PLE, theksohet se pari se në ankesën e paraqitur IRDK ka cekur vitin 2026 kurse ende jemi në vitin 2025. Tutje, në përgjigje në ankesë PLE thekson se ankesa është e pabazuar dhe pretendimet ankimore të IRDK-së nuk qendrojnë pasi që Bekim Tallamishi nuk është anëtar i PLE-së që nga viti 2020 dhe rrjedhimisht nuk përfaqëson askënd, perveq vetvetes. Poashtu, siç shihet edhe nga fotografitë e paraqitura nga ankuesi, ato janë nga viti 2016 dhe nuk kanë të bejnë fare me fushatën e zgjedhjeve të vitit 2025. Si provë, ka bashkangjitur komunikimin e vitit 2020 ku shihet se Bekim Tallamishi ka dhënë dorëheqje. Në videon e prezantuar me ankesë, nuk dihet koha kur është inqizuar video dhe video nuk përkon me stinën e dimrit në të cilën jemi.

Tutje, në përgjigje theksohet se i njëjti tregon në videon e prezantuar që i ka ardhur fahu postal nga KQZ për të votuar dhe deklaroi “votoni ata që meritojnë”, duke mos përmendur asnjë kandidat të PLE-së dhe vetëm thotë “unë e kreu obligimin tim dhe faleminderit” në këtë mënyrë duke mos rënë në kundërshtim me asnjë dispozitë ligjore në fuqi. Për më tepër, Bekim Tallamishi nuk është anëtar i PLE-së dhe i njëjti shihet qartë se ka shprehur bindjen e tij dhe nuk ka shkelur asnjë rregull apo proces të votimit, por që IRDK-ja tenton që me këto veprime të ia ndaloj votimin me postë të gjithë atyre që e shprehin një të drejtë ligjore dhe kushtetuese, siç është votimi me postë, por që votimi i të njëjtit nuk ka ndikuar të askush që të bëj ndonjë sjellje të pahijshme dhe si të tilla nuk ka prodhuar asnjë rezultat destruktiv apo ndonjë tension ndaj askujt dhe nuk përbejnë shkelje të nenit 34, par.1.1 të LZP-së. Duke u bazuar në gjendjen faktike, provat që gjenden në shkresat e dorëzuara në këtë përgjigje në ankesë, nuk vërtetëtohen në asnjë mënyrë që Bekim Tallamishi dhe PLE kanë shkelur dispozitat e LZP-së si dhe Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, andaj kërkojmë nga PZAP-i ta refuzoj në tërësi ankesën e paraqitur nga subjekti politik PLE, për faktin se nuk është vërtetuar asnjë pretendim i paraqitur në ankesë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës – PZAP-i, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pas administrimit të pretendimeve ankimore, gjeti se:

-Ankesa është e bazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës, provave të bashkangjitura-videoincizimit ku shihet personi me emrin Bekim Tallamishi i cili flet duke potencuar *“Pershendetje tash jemi tu i mbush për klientin ton për votat për zgjedhje të cilët i kemi, jemi tu i plotësu formularët kështu që i propozojmë të gjithëve që të merrni pjesë në zgjedhje dhe ju apeloj që të keni parasysh partinë liberale egjiptiane e cila punon dhe nderton për komunitetin tonë egjiptian. Ju faleminderit nga zemra, sot gjindem këtu në këtë ambient me shumë njerëz që jemi tu i rregullu letrat edhe tu ju ndihmu, ju faleminderit shumë”* po ashtu paneli mori parasysh edhe përgjigjen në ankesë të paraqitur nga Subjekti Politik PLE, dhe vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik IRDK, janë të bazuara dhe si të tilla i aprovoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë paraqesin shkelje të dispozitave të nenit 6 par. 2 të Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku percaktohet qartazi se vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.

Paneli ka konsideruar këtë veprim si shkelje të nenit 6, paragrafi 2 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, duke qenë se ky veprim shkel të drejtën e votës pasi që vota është personale, si dhe shkel fshehtësinë e votës, dhe është ndikim në vullnetin e votuesit.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet në ankesë janë të qëndrueshme dhe si të tilla i pranoi, sepse kjo shkelje ka të bëjë me faktin se veprimi i përshkruar në ankesën e parashtruar është në kundërshtim me dispozitat e nenit 6 paragrafi 2 i Ligjit NR.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Paneli, me rastin e vendosjes së gjombës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes si dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë. Kjo konsiston në faktin se Subjekti Politik PLE ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të votimit.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën parafë 1.3 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
ZP.Anr.29/2025, datë 22.12.2025



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.